



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.193/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Nenad Lazić dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lart ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR, për shkak të vendosjes së posterave brenda hapësirës 100m të Qendrës së Votimit(QV), në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa Anr.193/2017 e datës 11.06.2017, parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), paraqitur kundër subjektit politik LDK, për të vendosjes se posterave me afërsi se 100 metra nga QV-ja, në ditën e votimit.

### A r s y e t i m

Me datën 11.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në të cilën thekson se në afërsi të shkollës Shkëndija në qendrën e votimit 1927E në Prishtinë, monitoruesit e tyre kanë hasur në poster të kandidatëve për deputet dhe flamuj nga koalicioni LDK-AKR, të vendosura në hapësira publike deh në afërsi të shkollës më pak se 100 metra nga qendra e votimit.

Parashtruesi i ankesës thekson se me këto veprime është shkelur nen 36 paragrafi 1 i LZP-së, dhe konsideron se koalicioni LDK-AKR ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatëve për deputet dhe flamujt në hapësirë publike në afërsi të vendvotimit. Parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur tri foto të printuara dhe një CD.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar:**

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara nga parashtruesi i ankesës Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), nuk mund të identifikohet se ku gjendet në fakt Qendra e Votimit, për të cilën pretendohet në ankesë.

Andaj, nga arsyet e theksuar me lart e në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 193/2017 më datën 12.06.2017



**Kryesuesi i Panelit**  
Faton Ademi

**Këshillë Juridike:**

*Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.*